



**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**  
**AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU**  
**KOSOVO COMPETITION AUTHORITY**

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**RAPORTI I PUNËS 2018**

**VITI 2018**



TË DHËNAT E PUBLIKUARA

Publikuar nga:

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

Adresa:

Ndërtesa e ish “Bankës së Lubjanës”, kati VI

Rruga “Migjeni”, pn. Prishtinë

Tel: 038 200 109 82

Web: <http://ak.rks-gov.net>

Mars 2019

## Përshkrimi

|                                                                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| FJALA HYRËSE .....                                                                                          | 3  |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....                                                                                | 5  |
| KORNIZA LIGJORE .....                                                                                       | 6  |
| 1.1. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT .....                                                                       | 7  |
| PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT .....                                                                            | 9  |
| FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI .....                                                                   | 10 |
| RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE .....                                                           | 11 |
| MARRËVESHJET E NDALUARA/KARTELET .....                                                                      | 11 |
| 1. Rasti i datës: 10.01.2018 - Telekom kundrejt IPKO dhe DigitALB .....                                     | 11 |
| 2. Rasti i datës: 20.02.2018 - IPKO vs TELEKOMI dhe Z-Mobile .....                                          | 11 |
| 3. Rasti i datës: 30.03.208 - Furrëtarët e Komunës së Pejës.....                                            | 12 |
| 4. Rasti i datës: 04.05.2018 - Imatinib nga Lista esenciale (BIDRIGGING) .....                              | 13 |
| 5. Rasti i datës: 10.10.2018 - Vendim TK vs IPKO dhe DIGITALB.....                                          | 13 |
| 6. Rasti i datës: 16.10.2018, IPKO dhe Kujtesa Kunder TK, Ministrise se AD dhe<br>Ministrise se FSK-se..... | 16 |
| ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE .....                                                                          | 16 |
| 1. Rasti i datës: 12.02.2018 - KTV kundër IPKO-s .....                                                      | 16 |
| 2. Rasti i datës: 27.02.2018 - Operatorët ekonomik kundër BIK-ut.....                                       | 17 |
| PËRQËNDRIMET/BASHKIMET .....                                                                                | 18 |
| 1. Rasti i datës: 14.05.2018 - Përqendrimi i NEREGLIA TRADING dhe BETA GROUP .....                          | 18 |
| 2. Rasti i datës: 22.06.2018 - Përqendrimi i realizuar NKL Limited mbi Feronikeli .....                     | 18 |
| 3. Rasti i datës: 15.08.2018 - Përqendrimi i realizuar American Hospital mbi Hygea<br>Hospital.....         | 19 |
| BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR .....                                                                             | 20 |
| PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA TË PARAQITURA NË FORMË<br>TABELARE .....                      | 21 |
| SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT .....                                                               | 39 |
| RAPORTI FINANCIAR .....                                                                                     | 43 |
| RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-it .....                                                  | 43 |
| SHTOJCAT .....                                                                                              | 44 |

# FJALA HYRËSE

---

Valon PRESTRESHI

Kryetar, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, si institucion i pavarur, ka bërë një progres të suksesshem gjatë vitit 2018. Viti që lëm pas, përkon me shumë aktivitete të ndërmarrura nga Autoriteti, aktivitete të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Përveq tri fushave të cilat janë kompetencë e Autoritetit, *(marrëveshjet e ndaluara, abuzimi me pozitën dominuese dhe përqendrimet)* gjatë vitit 2018 ne kemi qenë aktiv edhe në fushën e avokimit, në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të brendshëm.

Gjatë vitit 2018 Autoriteti ka finalizuar kornizën legjislative të funksionimit të tijë dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka punuar në hartimin e koncept dokumentit për Ligjin e ri për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Gjithashtu Autoriteti ka ndryshuar strukturen organizative të tijë, fillimisht duke ngritur numrin e inspektorëve hetues dhe duke krijuar divizione të 4 fushave kryesore që trajtohen nga Autoriteti, me kusht që rastet të fasilitohet në mënyrë të drejt dhe profesionale.

Autoriteti ka inciuar raste të tregjeve të ndryshme. Një nder qeshtjet që Autoriteti i ka adresuar dhe atakuar është Udhezimi Administrative për përcaktimin e kushteve të Homologimit të Automjeteve. Për të parë nga afër nëse rekomandimet tona janë duke u implementuar, Autoriteti ka kërkuar me shkrim nga Ministria e Infrastrukturës, se sa po implementohet ato.

Me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtar dhe vendas, Autoriteti ka filluar të trajtoj raste të BidRigging (manipulimin me oferta) në tenderet publik, me konkretisht, në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë. Autoriteti bazuar në fakte të qendrueshme ka iniciuar procedurë hetimore kundrejt disa kompanive të cilat kanë ofruar çmime jo reale tregtare në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë.

Rasti tjetër i trajtuar nga Autoriteti është kontratat publike për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile të marrura nga organet shtetërore nga operatori ekonomik “telekomi i kosoves”. Me që rast, Autoriteti mbi bazën e fakteve të qendrueshme ka iniciuar procedure hetimore kundrejt pjesëmarrësve në këto kontrante.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjithashtu ka trajtuar dhe ka perfunduar një nder rastet me voluminose që ka pasur gjatë vitit 2018, rasti i marrëveshjes së IPKO-se dhe DIGITALBIT.

Ndërsa në fund të vitit 2018 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut të derivateve të naftës pas një reagimi të madh qytetare dhe mediatik mbi dyshimin e një marrëveshje të ndaluar ndërmjet operatoreve që afrojnë në këto treg.

Jane edhe raste të tjera të trajtuara nga Autoriteti, që me posht janë të elaboruar në mënyrë të detajuar.

Një kujdes të veçantë Autoriteti i ka kushtuar komunikimit me grupet e ndryshme të interesit dhe autoritetet e rëndësishme të shtetit. Në të gjitha rastet është bërë kujdes që komunikimi të jetë sa më transparent dhe i përshtatur në përputhje me karakteristikat kryesore të çdo grupi interesi.

Misioni unik i Autoritetit si garantues i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, do të mbetet prioriteti madhor i punës sonë në vitin 2019. Autoriteti do të mbetet një avokat i përkushtuar i konkurrencës së lirë dhe interesave të konsumatorit duke besuar se vetëm në këtë mënyrë do të përmbushë synimin final për më shumë zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.

Ju faleminderit.

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Në përputhje me detyrimin ligjor, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Raporti Vjetor për vitin 2018 i përshkruan aktivitetet e AKK-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AKK-së, duke i siguruar lidhur me transparencën e punës së tij dhe ndërgjegjësimin e ngritur për kulturën e konkurrencës në Republikën e Kosovës.

Përndryshe organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AKK-së janë përcaktuar në Statutin e tij, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

Komisioni i AKK-së është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, njeri prej të cilëve është kryetar i Komisionit. Kryetari i Komisionit udhëheq organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit.

Komisioni miraton vendimet e tij në mbledhjet e tij, me shumicën e votave, ku asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të abstenojë nga votimi. Vendimet mund të merren vetëm nëse në seancë janë të pranishëm kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit dhe së paku dy anëtarë të tjerë të tij.

Fushëveprimi i AKK-së konform Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës trajton tri (3) shtyllat kryesore të keqperdorimit apo shtremberimit të konkurrencës: 1. Marreveshjet e ndaluara - Kartelet, 2. Abuzimi me Poziten Dominuese, 3. Përqendrimet apo bashkimet.

Përveç aktiviteteve të AKK-së për zbatimin e rregullave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, AKK gjithashtu ka qenë në mënyrë aktive e përfshirë edhe në avokimin e konkurrencës.

Konkretisht, AKK ka marrë pjesë në tryeza diskutimi me ndermarrje të tregjeve të ndryshme, gjithashtu në bashkepunim me Autoritetin e Konkurrencës së Shqipërisë kemi mbajtur takim në qytetin e Kukësit me ndermarrjet që afrojnë në këto shtrirje gjeografike. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjithashtu ka qenë mjaft aktiv edhe në rrafshin e bashkepunimit ndërkombëtar duke nënshkruar Memorandume të Mirekuptimit me shtetin Kroat dhe Turk, dhe duke qenë aktiv në punëtori, seminar dhe konferenca ndërkombëtare neper bote dhe Evrope për qeshtje të Konkurrencës.

Në kuadër të aktiviteteve primare në fushën e konkurrencës në vitin 2018, AKK ka zgjidhur njëmbëdhjetë raste (11) raste, ka monitoruar pesë (5) tregje dhe ka tre (3) inicime të procedurës hetimore

Periudha e raportimit dhe sidomos pjesa e parë e vitit 2018 shënoi një aktivitet në rritje të AAK-së në fushën e kompletimit të legjislacionit sekondar, i cili është një rezultat i drejtpërdrejtë i konsolidimit global Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij rregullativ.

Të gjeturat kryesore të monitorimit të tregut nga ana e AKK-së publikohen rregullisht në përputhje me politikën e saj të transparencës dhe me qëllim të promovimit të efekteve të vendimeve, opinioneve dhe veprimtarive të tjera brenda komunitetit të biznesit, konsumatorëve, autoriteteve të administratës publike, akademikëve, ekspertëve dhe publikut të gjerë.

# KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i ngarkuar për zbatimin e këtyre akteve ligjore dhe nën ligjore, e të cilat janë:

- I. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- II. Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- III. Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312;
- IV. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative;
- V. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës - relevant;
- VI. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit;
- VII. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël;
- VIII. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve;
- IX. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 mbi kriteret për lirimin ose uljen e masës administrative;
- X. Rregullore Nr. 01/2016 mbi kushtet dhe rregullat e përdorimit të automjeteve zyrtare të AKK;
- XI. Kodi i mirësjelljes së AKK-së nr.01/2018
- XII. Rregullore Nr. 04/2018 e punës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- XIII. Rregullore nr. 03/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës
- XIV. Rregullore Nr.01-2017 për procedurën hetimore të AKK-së;
- XV. Udhëzim Administrativ Nr. 02-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjeve horizontale;
- XVI. Udhëzim Administrativ Nr.03-2017 mbi përjashtimet grupore të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve;
- XVII. Udhëzim Administrativ Nr. 04-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e transportit;
- XVIII. Udhëzim administrativ Nr. 05-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve
- XIX. Udhëzim Administrativ Nr. 06-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjes për d.s.a.m.



Ne bashkepunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni i AKK-se ka hartuar koncept dokumentin për Ligjin e Ri për Mbrojtjen e Konkurrencës i cili pritet të aprovohet në kuvend gjatë vitit 2019.



## 1.1. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurences në zbatim të rregullave të MSA-së, sipas të cilit është parashikuar detyrimi dhe angazhimi që ka Shteti i Kosovës për përafrimin e legjislacionit me atë evropian, përgjatë vitit 2018 ka vijuar këtë proces, duke synuar që kuadri ligjor në fushën e konkurrencës, të shkojë gradualisht drejt përafrimit të plotë me legjislacionin evropian.

Autoriteti Kosovar e konsideron shumë të rëndësishëm, jo vetëm procesin e përafrimit të këtij legjislacioni, por edhe shkallën e zbatueshmërisë së rregullave dhe dispozitave përkatëse.

Aktet e miratuara, në nivel sekondar nga Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2018, kanë synuar zbatimin e drejtimeve kryesore të politikave të konkurrencës, me qëllim që ato t'i vijnë në ndihmë dhe të lehtësojnë procedurat dhe kohëzgjatjen e tyre në sektorin e biznesit.

Në zbatim të ligjit nr. 03/L-229, gjatë vitit 2018 është miratuar Udhëzimet Administrative : për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative dhe Udhëzimi Administrativ për percaktimin e tregut relevant.

Nëpërmjet këtyre Udhëzimeve Administrative, synohet të normohet veprimtaria e biznesit, kur ai ndodhet përpara sjelljes së dyshimtë. Vendimet me angazhime, paraqesin angazhime të ofruara nga keto Udhëzime.

Autoriteti tani është në fazën e ndryshimit të Ligjit dhe në Koncept Dokumentin e dorezuar Qeverisë ka qenë i fokusuar për të injkorporuar brenda principet, rregullat dhe dispozitat bazike të BE-së për konkurrencë nga Traktati për Funksionimin e BE-së. Gjithashtu pjesërisht ka transponuar Rregulloren e Këshillit 1/2003/KE, Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 773/2004, dhe Rregulloren e Këshillit 139/2004/KE (të ashtuquajturat “Rregulloret bazë të konkurrencës”).

Legjislacioni dytësor që pjesërisht transponon legjislacionin e BE-së përfshin:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative - Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret të cilat Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti), duhet të marrë parasysh në procedurat e përcaktimit të kushteve për shqiptimin e masave administrative dhe gjatë shqiptimit të masave ndëshkuese administrative ndërmarrjeve të cilat kanë shkelur dispozitat e nenëve 56 - 58 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (në tekstin e mëtejshëm Ligji). Qëllimi masave ndëshkuese administrative nga paragrafi 1 i këtij neni, është dënimi (sanksionimi) i kryerësve të shkeljes së Ligjit, eliminimin e efekteve të dëmshme të shkeljes së Ligjit, dekurajimin e ndërmarrësve tjerë nga shkeljet e dispozitave të Ligjit dhe të sigurojë konkurrencë efektive në treg. Shuma maksimale e masës ndëshkuese administrative të cilën Autoriteti mund t'ua shqiptoj ndërmarrjes bazuar në këtë udhëzim administrativ për shkelje të dispozitave të Ligjit nuk mund të kalojë shumën e përcaktuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit dhe nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.
- UA nr. 02/2018 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës - relevant, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për Definimin e Tregut Relevant për qëllime të legjislacionit të konkurrencës së Komunitetit (OJ/C 372 e 9 Dhjetorit 1997); Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra dhe kriteret për përkufizimin e tregut relevant si bazë për llogaritjen e pjesëmarrjes në treg, në procedurat të cilat i zbaton Autoriteti për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm Ligji). Udhëzimi Administrativ zbatohet gjatë kryerjes së hetimit paraprak të gjendjes në tregun relevant me qëllim të vërtetimit të ekzistencës së indikacioneve të



mjaftueshme për fillimin e procedurës, si dhe në procedurat e përcaktimit të marrëveshjeve të ndaluara të ndërmarrjeve, konstatimit të abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjeve dhe vlerësimin e lejueshmërisë së përqendrimeve.

- UA nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël, që pjesërisht transponon Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet e rëndësisë së vogël (de minimis) që nuk kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81 pika 1 (tani neni 101) i Traktatit që themelon Komunitetin Evropian (OJ/C 368/13, e datës 22 Dhjetor 2001)<sup>1</sup>;
- UA nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve - që transponon elemente të kërkesës dhe kriterëve për bashkimin/përqendrimin të definuar në Rregulloren e Komisionit Nr 802/2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Megjithatë, kjo rregullore është amandamentuar nga Rregullorja Zbatuese e Komisionit nr. 1269/2013 bashkë me anekse, dhe duhet që legjislacioni jonë dytësor të rishikohet në planin afatmesëm për t'u përafëruar më tutje me këtë legjislacion sekondar mjaft voluminoz për përqendrimin.
- UA nr. 07/2012 mbi kriteret për lirin ose uljen e masës administrative - e cila transponon Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 773/2004 e datës 7 prill 2004 në lidhje me zhvillimin e procedurave nga Komisioni në përputhje me nenet 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së e amandamentuar në Rregulloren nr. 2015/1348.

Gjatë vitit 2018 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka vazhduar me nxjerrjen e rregulloreve të reja duke bërë ristrukturimin e Institucionit dhe ka miratur Kodin e mirësjelljes së AKK-së.

- Rregulloren nr. 03/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me këtë Rregullore përcaktohet organizimi i brendshëm, sistematizimi i vendeve të punës dhe përshkrimi i detyrave të punës në Sekretariatit e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, duke përfshirë kriteret dhe procedurat për klasifikimin e vendeve të punës, gradave, funksionet dhe përgjegjësitë e njësive organizative, përcaktimin e niveleve përkatëse drejtuese të udhëheqësve të njësive organizative, si dhe autorizimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Kodi i mirësjelljes nr.01/2018 i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka për qëllim të përcaktoj rregullat e sjelljes dhe parimet etike në bazë të cilave punojnë nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me misionin e këtij institucioni të pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij në funksion të ruajtjes dhe afirmimit të standardeve të mirësjelljes si dhe ngritjen e dinjitetit dhe imazhit të tij
- Plotësim ndryshimin e Rregullores nr.04/2018 të punës së Komisionit të AKK-se - Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe parimeve për organizimin e punës dhe funksionimin efikas të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

---

<sup>1</sup> [https://ak.rks-gov.net/kuadri\\_ligjor](https://ak.rks-gov.net/kuadri_ligjor)

# PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 07 nëntor 2008, në bazë të Ligjit për Konkurrencën Nr. 2004/36.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike i cili në mënyrë të mëvetësishme dhe të pavarur i kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Qëllimi i mbrojtjes së konkurrencës është para së gjithash krijimi i përfitimeve për konsumatorët dhe krijimi i kushteve të barabarta për të gjitha bizneset në treg, të cilat duke u sjellur në pajtim me rregullat ekzistuese dhe duke garuar në treg me cilësitë, çmimet dhe inovacionet e produkteve dhe shërbimeve të tyre, i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Kur kemi të bëjmë me ndërmarrësit dhe sjelljet e tyre antikonkurrese, si për shembull lidhja e Marrëveshjeve me

konkurrentët për çmimet, abuzimi me pozitën dominuese ose kontrolli i përqendrimeve, pra bashkimi dhe zmadhimi i ndërmarrësve, Autoriteti e bënë vlerësimin e sjelljeve të tilla i ndëshkon shkelësit e rregullave dhe ju dërgon mesazhe unike të gjithë pjesëmarrësëve në treg. Pra iniciativat e lira të ndërmarrësve nuk guxojnë të kufizohen, por zhvillimi i tyre kryhet sipas rregullave rigorozë të konkurrencës në treg, të cilat nuk janë vetëm represive, por edhe parandaluese.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Autoritetit është promovimi i kulturës së konkurrencës dhe hetimi i veprimeve të ndërmarrjeve të cilat shtremberojnë dhe kufizojnë konkurrencën e lire dhe efektive.

Qëllimi ynë është që t'i kontribuojmë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e Autoriteteve ekzekutive, legjislative e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtresat e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës.

Nga konkurrenca në fund të fundit përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikon në rritjen ekonomike.

Andaj edhe rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e promovimit të saj është detyrë e jona.

# FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

---

## Struktura organizative e Autoritetit

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni që është organ kolegjal vendimmarrës dhe Sekretariati që e përbëjnë nëpunësit civil si staf profesional dhe mbështetës.

## Struktura organizative e Sekretariatit

Sekretariati i Autoritetit është organ administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e rasteve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati pas monitorimit dhe hetimeve harton raportet të cilat paraqiten pranë Komisionit për vendimmarrje.

*Sekretariati përbëhet nga dy Departamente:*

### 1. Departamenti Juridik dhe Administratës

Zhvillon politikat kadrovike dhe planet e Autoritetit për menaxhimin e personelit, koordinon procesin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve, siguron përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të propozuara nga Autoriteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*Acquis Communautaire*) si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ky Departament në bashkëpunim me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve përgatit planifikimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të KASH-it, SZHMB-së, planit të keshit, pasqyrave e raporteve financiare, barazimet me Thesarin, regjistrimin e të hyrave, si dhe siguron e mbikëqyr shërbimet teknike si mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e rregullt të automjeteve, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ky Departament ka 6 të punësuar dhe ka nevojë edhe për 1 zyrtarë të lartë ligjor.

### 2. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut

Mision kryesor ka hetimin e shkeljeve të konkurrencës në treg, ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky Departament synon që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara me ligj, të mbikëqyr tregun dhe të propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të saj në treg, mbikëqyrë hetimin e tregjeve ku shfaqen praktikant anti-konkurrese, si ato të abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe nëpërmjet përqendrimeve që krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese pas përqendrimit, ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset dhe nga institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të përfshira ose jo nën hetim, etj.

Ky Departament ka 4 divizione (dv. Anti-Kartel, dv. i Pozites Dominuese, dv. i përqendrimeve dhe dv. i analizes, metodologjise dhe te drejtave ekskluzive).

## MARRËVESHJET E NDALUARA/KARTELET

### 1. Rasti i datës: 10.01.2018 - Telekomit kundrejt IPKO dhe DigitALB

Është vendosur me Konkluzion për iniciimin e procedurës Hetimore kundrejt IPKO dhe DigitALB

Autoriteti është kompetent për marrjen e iniciativës për fillimin e procedurës sipas detyrës zyrtare, bazuar në kërkesat, propozimin, kundërshtimin ose ndonjë paraqitje tjetër në formë të shkruar. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kontrata-marrëveshja ekskluzive, parandalon, kufizon dhe keqpërdorë konkurrencën në dëm të subjekteve tjera të cilat veprojnë në tregun e telekomunikimeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Pretendimet janë se kjo kontratë ka tipare të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 të Ligjit 03-L229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke pamundësuar konkurrencën në mes të operatorëve legal të licencuar në tregun përkatës, vlen të theksohet se parashtruesi i kërkesës pretendon po ashtu edhe shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve 2004/17 për dëmtrim të konsumatorëve të Republikës së Kosovës nga qasja konkurruese për këto produkte shitje dhe distribuimin e pakove televizive të prodhuesit “Digit Alb Sh.A. për tregun e Republikës së Kosovës.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ofruar nga paraqitësi i kërkesës paraprakisht shprehim se marrëveshja në fjalë sipas pretendimeve të paraqitesit të kërkesës, aludohet se ka si objekt dhe pasojë disa kufizime të konkurrencës, ndërsa për t’i sqaruar të gjitha këto pretendime Autoriteti duhet, që të sigurojë dhe të konsultojë klauzolat e Marrëveshjes Ekskluzive, të atakuar.

### 2. Rasti i datës: 20.02.2018 - IPKO vs TELEKOMI dhe Z-Mobile

Është vendosur me Konkluzion për mos hapje të procedurës Hetimore

Marrëveshjet nga Autoriteti trajtohen si raste in perse (shkelje në vetvete), ndërsa për keqpërdorimin e Pozitës Dominuese vlen rregulli rule of reason (rregullat e arsyes), se çfarë u tha më lartë, marrëveshja MNO dhe MVNO janë marrëveshje të rregulluara me ligje dhe akte nënligjore si dhe direktivat ndërkombëtare. Këto marrëveshje janë të rregulluara nga rregullatori përkatës e si të tilla në parim nuk bien ndesh me rregullat e konkurrencës.

Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t’u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës.

Përfundimisht, këto marrëveshje i’u mundësojnë MVNO-ve që të hyn në konkurrencë me operatorët ekzistues, jo vetëm në aspekt të çmimeve por edhe në aspektin e llojeve të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, siguron që pjesëmarrësit në një treg të kenë qasje të barabartë dhe të lirë, të jenë të pavarur, caktimi i çmimit të jetë i bazuar kryesisht në ofertë dhe kërkesë dhe të konkurrojnë njëri tjetrin me cilësi të shërbimeve dhe produkteve.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

### **3. Rasti** i datës: **30.03.2018 - Furrëtarët e Komunës së Pejës**

#### **Vendim për marrjen e obligimeve**

Pronarët e furrave në Komunën e Pejës me datën 18.08.2017, kanë mbajtur mbledhje në qendrën tregtare Zejtare Iliriana dhe në këtë takim është diskutuar për ngritjen e çmimit të bukës. Në këtë takim nuk kanë arritur Marrëveshje për rritjen e çmimit, mirëpo fiksimi/ngritja e çmimit të bukës është bërë në takimin e dytë në restorant “Delta” në Pejë. Ky takim ka ndodhur orientimisht me datën 25.08.2017. Në këtë Mbledhje kanë rënë dakord që nga data 1 shtator 2017, të ngritet çmimi i bukës nga 0.30 në 0.40 cent. Gjatë shqyrtimit paraprak në tregun relevant AKK-se ka vërejtur se në të gjithat furrat e Komunës së Pejës çmimi i bukës kishte ngritje nga 0.30 cent në 0.40 cent.

Me shkresën e datës 16.02.2018, të 13-të furrar të Komunës së Pejës kanë marrë për sipër se mënyra e përcaktimit të çmimeve do të bëhet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg, këto detyrime i kanë marrë për t'i eliminuar efektet negative të veprimeve dhe lëshimeve në konkurrencën tregtare.

Autoriteti për t'i vërtetuar zotimet e furrarëve ka monitoruar tregun në Komunën e Pejës me të cilin ka siguruar dëshmi se tregu është konkurrues, çmimi i bukës standarde është i ndryshëm duke filluar nga çmimi 0.30 cent, 0.33 cent, 0.35 cent, 0.37 cent, dhe 0.40 cent.

AKK vlerëson se në tregun përkatës masat e propozuara nga të 13-të furrar të Komunës së Pejës kanë marrë për sipër se mënyra e përcaktimit të çmimeve do të bëhet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg, këto detyrime i kanë marrë për t'i eliminuar efektet negative të veprimeve dhe lëshimeve në konkurrencën tregtare.

AKK konstaton se kërkesa e furrarëve dhe dëshmitë që i posedon AKK janë të mjaftueshme për të eliminuar efektet negative dhe rivendosjen e konkurrencës në treg, dhe bëhen të detyrueshme për propozuesit sipas nenit 46, Paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, me ç'rast do të vinte në shprehje edhe interesi i konsumatorit në veçanti, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillim, mundësi zgjedhje, zëvendësueshmëri të produktit apo shërbimeve dhe garë ndërmjet operatorëve ekonomik.

#### 4. Rasti i datës: 04.05.2018 - Imatinib nga Lista esenciale (BIDRIGGING)

Është vendosur me Konkluzion për fillimin e procedurës hetimore

Përshkrimi i rastit: Ministria e Shëndetësisë ndër vite sipas nevojave dhe kërkesave ka shpallur tender me procedurë të hapur për furnizim me barna nga Lista Esenciale, në të cilët tender ka qenë i përcaktuar në Lloje të ndryshme bari IMAKREBIN - Imatinib Mesylate 400mg. Ky bari shpërndahet falas nga barnatorja qendrore e SHSKUK-së dhe përdoret nga pacientët që vuajnë nga sëmundje të rënda kanceroze dhe leukemisë. Kërkesat ndër vite (nga 2015 deri në vitin 2017) të MSH-së sipas evidencës sonë, të siguruara nga MSH, SHSKUK, Dogana e Kosovës, duket se janë të ndryshme. Po ashtu edhe çmimet e importuara për këtë bari janë të ndryshme, nga prodhues e vende të ndryshme. Sipas evidencës Furnizimi me këtë lloj bari ka filluar me kontratën publike kornizë të MSH-së në vitin 2012 dhe ka vazhduar deri më tetor 2017. Nëse bëjmë krahasimin e çmimeve të importit/shitje me pakicë dhe çmimeve të kontraktuara në tenderët publik vërehet se ekziston dyshimi se kompanitë kanë ofruar çmim jo real të shitjes, krahasuar në çmimet doganore të importuara. Dyshimet e AKK-së janë mbi atë se ndërmarrjet kanë arritur Marrëveshje e ndaluar ndërmjet operatorëve ekonomik ose janë koordinuar për të bashkërenduar aktivitetet e tyre të cilët në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve për blerësit në këtë rast “autoritetet kontraktuese” të cilët kanë pasur nevojë të sigurojnë produktet nëpërmjet procedurave të prokurimit publik për Listën Esenciale të barnave. Sipas evidencës sonë në ofertat tenderuese ka sinjale se këta ndërmarrje kanë aplikuar metodën apo parimin e rotacionit në kurdije të tenderëve në të qenurit fitues.

#### 5. Rasti i datës: 10.10.2018 - Vendim TK vs IPKO dhe DIGITALB

Është vendosur me VENDIM se marreveshja IPKO - DIGITALB nuk e crregullon konkurrencen.

1. Për të vlerësuar Marrëveshjen e bashkëpunimit të ndërmarrjeve DigitALB dhe IPKO, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka përdorur nenin 3 par. 1.1 dhe nenin 66 të Ligjit për Mbrotjtjen e Konkurrencës citoi: “Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën”.

2. Duke u bazuar në “Guidelines on Vertical Restraints” përkthyer në shqip (Udhëzime mbi Kufizimet vertikale) të Komisionit Evropian pika 96 - 2291, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, e përcakton si MARRËVESHJE VERTIKALE,

3. Duke u bazuar në “Guidelines on Vertical Restraints” përkthyer në shqip (Udhëzime mbi Kufizimet vertikale) të Komisionit Evropian pika 96 - 2292, format e Marrëveshjeve vertikale janë:

3.1. Marrëveshje për një markë të vetme (Single branding) - Marrëveshja për Shitjen vetëm individëve me te njëjtën markë. 3.2. Shpërndarje Ekskluzive (Exclusive distribution) - Marrëveshja për shpërndarje ekskluzive (për përjashtimin e te tjerëve ne hapësirën e caktuar gjeografike). 3.3. Alokim ekskluziv i konsumatorëve (Exclusive customer allocation) -- Marrëveshja për Alokimin ekskluziv te konsumatorëve - (shitja vetëm një distributori për shitje te mëtutjeshme grupit te caktuar te konsumatorëve). 3.4. Shpërndarje Selektive (Selective distribution) - Marrëveshja për shpërndarje selektive (jo te gjithë ndërmjetësuesve, por jo vetëm njërit. 3.5. Franshiza (Franchising) - Marrëveshja për franshizën 3.6. Furnizim Ekskluziv (Exclusive supply) - Marrëveshja për furnizim ekskluziv 3.7. Kompensim për qasje në rrjetë (Upfront access payments) Marrëveshja për paradhënie (pages paraprake) - (avans) për qasje



në rrjetë. 3.8. Marrëveshjet e menaxhimit të kategorisë (Category management agreements) Marrëveshja e menaxhimit të artikujve të ngjashëm - kategorisë 3.9. Lidhjet (Tying) - Marrëveshja për shitjen e produkteve të lidhura - nëse dëshiron me e ble një produkt atëherë je i detyruar me e ble edhe produktin tjetër. 3.10. Marrëveshja e kufizimit të çmimeve të rishitjes (Resale price restrictions) - Kjo metodë përdoret kur shitësi ia shton disa vlera të ngjashme nga mallrat të cilat zotërohen prej ndërmarrjeve shoqëruese. ... Metoda e çmimit të rishitjes fillon me çmimin e lire (pa presion të përcaktuar) të rishitjes (të një malli të blerë nga njësitë ekonomike jo-te lira ), duke minimizuar margjinën e ngjashme bruto.

#### KËSHTU QË:

1. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko ka si objekt që t'i jep të drejtën ekskluzive Ipkos's të shpërndajë në platformën e vet kabllore kanalet të përcaktuar nga palët, pjesë e platformës DigitALB të cilat do të ofrohen nga DigitALB.

#### ANDAJ

2. Kjo marrëveshje vertikale, duke u bazuar në "Guidelines on vertical restraints" të Komisionit Evropian pika 2.2 paragrafi 151, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës e cilëson si marrëveshje ekskluzive të shpërndarjes, sepse në një marrëveshje ekskluzive të shpërndarjes, furnizuesi pranon të shesë produktet e tij vetëm për një distributor për rishitje në një territor të caktuar.<sup>3</sup>

3. Për të vlerësuar Marrëveshjen Ekskluzive të Shpërndarjes e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, nëse përmban dispozita të cilat kanë si objekt dhe pasojë disa kufizime të konkurrencës, Autoriteti duke u bazuar në "Udhëzuesin mbi kufizimet vertikale" të Komisionit Evropian pika 1.2 paragrafi 106 ka marr për bazë dhe analizuar "Efektet Pozitive të Kufizimeve Vertikale" dhe "Efektet Negative të Kufizimeve Vertikale".

4. Ky udhëzues mbi kufizimet vertikale përpiket të japë një pasqyrë të drejtë të justifikimeve të ndryshme për kufizimet vertikale. Arsyet e mëposhtme mund të justifikojnë zbatimin e kufizimeve të caktuara vertikale:

Terminologji e huaj për çështje të politikave të Konkurrencës

a. To "solve a "free-rider" problem". - zgjidhja e problemit të shfrytëzimit falas (te të mirave publike ( si të shpërndahet në mënyrë të barabartë kostoja) b. To "open up or enter new markets" - Strategjia e hyrjes në tregjet e reja c. The "certification free-rider issue" - Çështja e certifikimit të shfrytëzimit falas d. The so-called "hold-up problem" - I ashtuquajtur problem i mbetur (ngurrimi për të bashkëpunuar me qellim që mos të fuqizohet bashkëpunëtori) e. The "specific hold-up problem" - Problemi specifik i mbetur f. The "vertical externality issue" - Çështja e shoqërimit (përcjelljes) vertikale (efektet ose pasojat anësore psh. Ndotja). g. "Economies of scale in distribution"- Vëllimi (shkalla) i aktivitetit në shpërndarje h. "Capital market imperfections" - Jo përkryerja e tregut të kapitalit (Të gjitha kufizimet të cilat e zvogëlojnë gamën e kontratave financiare që agjentët mund të nënshkruajnë dhe / ose që i pengojnë ata të bëhen të ndershëm quhen jo përkryerje. Këto kufizime janë më të zakonshme në tregjet e kapitalit). i. "Uniformity and quality standardisation" - Standardizimi kualitativ i një trajtshëm

5. Kjo Marrëveshje Ekskluzive e Shpërndarjes e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitALB dhe Ipko, Autoriteti e justifikon si "Uniformitet dhe standardizim të cilësisë" dhe "Ekonomi e shkallëzuar"



a. Uniformiteti dhe standardizimi i cilësisë, në një kufizim vertikal mund të ndihmojë në krijimin e një imazhi të markës duke imponuar një shpërndarje të caktuar të uniformitetit dhe standardizimit të cilësisë, duke rritur atraktivitetin e produktit tek konsumatori përfundimtar dhe duke rritur shitjet e tij (produktit).

i. Në rastin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes DigitAlb dhe IPKO, produktet e ofruara nga IPKO për konsumatorin përfundimtarë në territorin e Republikës së Kosovës ka rezultuar në përmirësimin e programeve audiovizuele cilësore, zhvillim apo inovacione të produkteve me çmime konkurruese në treg dhe ngritje të atraktivitetit të produktit. Gjithashtu këto dy ndërmarrje në platformën kabllore të IPKO-së kanë krijuar një imazh të brendeve apo markave të tyre me të cilat kanë ngritur besueshmërinë tek konsumatorët, e gjithë kjo si rezultat i “Uniformitetit dhe standardizimit të cilësisë.”

b. Ekonomitë e shkallës - Për të shfrytëzuar ekonomitë në shkallë dhe për të parë një çmim më të ulët për produktin e tij, prodhuesi apo furnizuesi mund të dëshirojë të përqendrojë rishitjen e shërbimeve apo produkteve të tij në një numër të kufizuar shpërndarës.

i. Në rastin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes DigitAlb dhe IPKO - Marrëveshja vertikale mund të arsyetohet si “Ekonomitë e shkallës”, duke e bërë kufizimin e një numri të distributorëve të caktuar, p.sh. përmes përzgjedhjes selektive të distribuimit i’u mundësohet prodhuesit apo furnizuesit për arritjen e “ekonomisë së shkallëzuar” duke i’u mundësuar atij të caktoj çmimin më të ultë të shitjes me pakicë për produktin e tij, sepse përmes marrëveshjeve vertikale prodhueseve apo furnizuesve i’u mundësohet më lehtë të futen në tregje të reja. Nëse prodhuesi apo furnizuesi pretendon të futet në një treg të caktuar, p.sh. për të eksportuar në një shtet tjetër ai duhet që të sigurojë një lloj mbrojtje “Territoriale” distributorit për shkak të investimeve që distributori ka bërë me kusht që ai produkt apo shërbim të jetë i pranuar në tregun e ri.

## NDËRSA

6. Efektet negative në treg që mund të rezultojnë nga kufizimet vertikale të cilat ligji i BE-së për konkurrencë synon t’i parandaloj janë si në vijim:

a. Mbyllje të tregut anti-konkurrues e furnizuesve të tjerë ose blerësve të tjerë duke rritur barrierat për hyrje apo zgjerim. (orig. anticompetitive foreclosure of other suppliers or other buyers by raising barriers to entry or expansion).

b. Nga kjo Marrëveshje Ekskluzive e Shpërndarjes e lidhur ndërmjet ndërmarrjeve DigitAlb dhe Ipko, Autoriteti konsideron se nuk paraqet mbyllje (foreclosure) të tregut përkatës sipas pikës (a) të lartëcekur sepse në tregun përkatës të ofrimit të shërbimeve mediale audiovizuele bazuar në Adresarin e Operatorëve të Shpërndarjes të Licensuar në Kosovë e siguruar nga Komisioni i Pavarur për Media4 figurojnë tridhjetë e nëntë (39) operatorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Kosovës. Njëherazi nuk mund të konsiderohet mbyllje (foreclosure) e tregut përkatës sepse ndërmarrjet në marrëveshje nuk janë duke i:

i. dëmtuar konsumatorët ii. duke rritur çmimet me shumicë të produkteve, iii. duke kufizuar zgjedhjen e produkteve, iv. duke ulur cilësinë e tyre ose v. duke ulur nivelin e inovacionit të produktit.

Si dhe mundësia e konsumatorëve për të lëvizur nga një operator kabllor në tjetrin nuk paraqet pengesa të ndrrimit të operatorëve kabllor nga konsumatori fundorë.

## **6. Rasti** i datës: 16.10.2018, IPKO dhe Kujtesa Kunder TK, Ministrise se AD dhe Ministrise se FSK-se

Është vendosur me Konkluzion për fillimin e procedures hetimore

Nga vlerësimi i dokumentacionit të ofruar nga paraqitësit e kërkesës paraprakisht shprehim se marrëveshjet në fjalë sipas pretendimeve të paraqitësve të kërkesës, aludohet se ka si objekt dhe pasojë kufizime të konkurrencës, ndërsa për t'i sqaruar të gjitha këto pretendime Autoriteti duhet që të sigurojë dhe të konsultojë klauzolat e Kontratave/Marrëveshjeve.

## **ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE**

### **1. Rasti** i datës: 12.02.2018 - KTV kundër IPKO-s

Është vendosur me Konkluzion për mos hapje të procedurës Hetimore

Gjatë analizimit të dokumentacionit dhe infrastrukturës ligjore, Autoriteti ka konstatuar se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj IPKO Telecommunications Sh.p.k. për faktin se nuk ka argumente se IPKO në vitin 2013 ka keqpërdorur pozitën e saj dominuese në tregun përkatës e cila e kishte ri renditur kanalin e KTV-së nga nr. rendor 03 në 83.

Renditja e kanalit televiziv KTV-së në nr. 83, nuk kishte ndikuar në çrregullimin e konkurrencës në tregun përkatës, për shkak se klienti apo abonuesi i platformës digjitale kablore të IPKO-së ka pasur mundësi ligjore dhe teknike pa pengesë t'i shikoj të gjitha kanalet televizive si dhe të krijoj Listën Favorite të shikueshmërisë sipas preferencës së abonuesit.

Në bazë të dispozitave të Rregullores së KPM-së CIMC-2007/04, për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, nuk e obligonte asnjë operator kabllor që paraprakisht kanalet televizive t'i rendit sipas kësaj Rregulloreje mirëpo i jepet si kompetencë që Këshilli Programor i operatorit kabllor të bëjë renditjen e kanaleve televizive duke u bazuar në ofertën dhe kërkesën në treg.

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit dhe situatës në tregun përkatës Autoriteti ka vlerësuar se ri renditja e kanaleve televizive nga ana e IPKO Telecommunications Sh.p.k. është bërë në suaza të fushëveprimit të saj si kompani dhe ka cilësuar se këto veprime nuk e kanë dëmtuar KTV-në si televizion nacional e me këtë as konkurrencën aktuale dhe potenciale në raport me televizionet tjera në tregun relevant.

Në bazë të shërbimeve që ka ofruar IPKO përmes resiverëve Kaon, Smart box dhe GLEE abonuesi ka pas mundësin të krijojë Listën Favorite të kanaleve. Nga analiza e konkurrencës është konstatuar se KTV si televizion nuk është dëmtuar shikueshmëria e as abonuesi i cili e ka pas mundësin ta ketë KTV-në në Listën e vet preferenciale të shikueshmërisë.

Sipas evidencës së të dhënave dhe cilësimit të kësaj sjellje të IPKO-së në treg, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

## 2. Rasti i datës: 27.02.2018 - Operatorët ekonomik kundër BIK-ut

Është vendosur me Konkluzion për mos hapje të procedurës Hetimore

Në bazë të gjitha fakteve të prezantuar nga ana e operatoreve ekonomik po ashtu edhe nga Bashkësia islame e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës vlerësojmë se:

1. Në bazë të vendimit të komunës së Prishtinës lidhur me pagesën e shpenzimeve familjeve që përfshijnë humbjen e anëtarëve të familjes nuk kufizohet konkurrenca në mes të operatorëve ekonomik dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.
2. Interpretimi i vendimit të komunës së Prishtinës nr. 01/400/93043 i datës 30.04.2015 në mënyrë decisive përcakton se çka cilësohen shërbime funerale (transporti i kufomave) dhe po ashtu përcaktohen ritet fetare.  
Sipas këtij interpretimi me nr. 14-120/03-0220162/17 të datës 31.08.2017 transporti i kufomave i është lënë që qytetarët të jenë të lirë të zgjedhin se me cilin operatorë ekonomik do t'i kryejnë këto shërbime të transportit funebre.
3. Shërbimet fetare (ritualet fetare) sipas interpretimit të zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës nënkupton të gjitha shërbimet që i ofrojnë Bashkësitë Fetare (në këtë rast BIK - dega e Prishtinës) për të cilat e kanë ekskluzivitetin dhe nuk mund të kryejnë ndonjë organ, institucion, apo operator tjetër ekonomik.
4. Marrëveshja e bashkëpunimit e datës 02.03.2016 në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencisë së Regjistrimit Civil, Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës e cila ka për qëllim sigurimin dhe shkëmbimin e informacionit në mes këtyre institucioneve të lartpërmendura për rastet e konfirmuara të vdekjes së qytetarëve në Republikën e Kosovës.

Të gjitha dëshmitë që kemi marrë gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit tregojnë se nuk ka shkelje të konkurrencës në tregun e transportit funeral ndërsa për çështjet e tjera që operatorët ekonomik kanë kërkuar që shërbimet funerale të përfshijnë edhe një pjesë të shërbimeve (ritualeve) fetare kjo nuk iu e lejohej pasi Bashkësitë fetare e kanë ekskluzivitetin sipas ligjeve në fuqi dhe formës së organizimit të tyre në Republikën e Kosovës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit të ofruar nga palët dhe takimeve të realizuara, ka ardhur në përfundim se nuk ka fakte dhe argumente mbi bazën e të cilave mund të fillojmë iniciativën e procedurës për hetim. Autoriteti në bazë të kompetencave ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës përkatësisht nga zyra ligjore që të interpretojë vendimin me nr. Prot. 01/400/93043 i datës 30.04.2015 përkatësisht pikën 2.

Sipas evidencës së të dhënave dhe vlerësimit të këtij vendimi të Komunës së Prishtinës, dhe sjelljeve në tregun përkatës të Bashkësisë Islame të Kosovës - dega në Prishtinë, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

# PËRQËNDRIMET/BASHKIMET

## 1. Rasti i datës: 14.05.2018 - Përqendrimi i NEREGLIA TRADING dhe BETA GROUP

Vendim për Lejimin e përqendrimit të Realizuar.

Blerjen (aksioneve ) të nënshkruar më datë 02.03.2018 ( Kontratë e Shitblerjes) ndërmjet NEREGLIA TRADING LTD dhe Beta Group Shpk., në cilësinë e blerësve ( në vijim bashkërisht te quajtur “Blerësit”) dhe Elizabeth CUTTING MCFADDEN, Iro PAPATHANASOPOULOU, Petro KUMI, Ilias ASIMAKOPOULOS, Ilias VOUTERIS, Georgios MELA, Ioannis-John KYNIGOPOULOS në cilësinë e shitësve (në vijim bashkërisht quajtur “Shitësit”). Ndërmjet Kontratës së Shitblerjes do të realizohen transferimi i 100% i pronësisë së ALL BALCANS CORPORATION Sha. si (palë shitëse), një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K51414005B, me seli në adresën Rruga Gjergj Legisi, ish Umb, Laprakë-Tiranë Shqipëri, tek (pala blerëse) NEREGLIA TRADING LTD Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Qipros, me numër HE 9551, me seli në adresën Griva Digeni, Godina Panyides, Kati 2, Zyra 3, P.O.Box 56250,3305, Limassol, Qipro dhe Beta Group Shpk., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtare të Kosovës pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me numër 810027468, me seli në adresën Rr. Sadik Shala, Lipjan, Kosovë.

Baza ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që: a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumë 20 milion euro b) Njëra nga palët blerëse është e regjistruar në Republikën e Kosovës c) Kontrata e Shitblerjes ndërmjetës palëve, datë 02.03.2018.

Blerja e propozuar gjithashtu është lajmëruar edhe tek Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri.

## 2. Rasti i datës: 22.06.2018 - Përqendrimi i realizuar NKL Limited mbi Feronikeli

Lejimi i përqendrimit mbi NewCo Feronikeli Complex LLC

Vlerësimi i transaksionit në raport Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës në tregun përkatës, nga taransaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar është transaksion që nuk ka efekt në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, por vetëm në atë ndërkombëtar. Nga transaksioni nuk do të rezultojnë efekte negative për konkurrencën e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Autoriteti vlerëson se autorizimi për këtë përqendrim do të vlerësohet vetëm në fazën e parë, si në vijim ;

Në rastet kur Autoriteti në procedurë të shkurtër duhet të vlerëson qëllimin e realizimit të përqendrimit, atëherë ndërmarrja i dorëzon Autoritetit një njoftim të shkurtër për përqendrimin. Procedura e shkurtër e vlerësimit të qëllimit të realizimit të përqendrimit bëhet veçanërisht në raste si vijon:

- Kur asnjë pjesëmarrës në përqendrim nuk vepron në tregun e njëjtë relevant në kuptimin gjeografik dhe produktit dhe kur në mes tyre nuk ka marrëveshje horizontale, apo kur asnjëri

nga pjesëmarrësit nuk vepron në tregun në të cilin rëniet dhe ngritjet, në raport me tregun në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër i përqendrimit nuk ka lidhje vertikale.

Një ndër specifikat e realizimit të përqendrimit potencial dhe poashtu sipas kërkesës për qëllimin e përqendrimit konkludojmë se nuk është e nevojshme të evaluohet pozita dhe pjesëmarrja në treg si dhe fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes-blerësit në tregun relevant, shkallën e aftësisë konkurruese të pjesëmarrësve në përqendrim, sepse TARGETI nuk ka konkurrent në Republikën e Kosovës e gjithashtu tregu i TARGETIT nuk është Kosova, e sa i përket pozitës së NKL Limited, të njëjtit janë blerës që lindin si pasojë e përqendrimit.

### **3. Rasti i datës: 15.08.2018 - Përqendrimi i realizuar American Hospital mbi Hygea Hospital**

#### **Lejimi i përqendrimit mbi Hygea Hospital**

Nga dokumentacioni i ofruar vlerësojmë se, tregu relevant, konkurrentët ekzistues apo konkurrentët e mundshëm të degës së huaj të regjistruar në Republikën e Kosovës në veçanti, strukturën dhe zgjedhjen e ofertës dhe kërkesës në treg dhe trendët e tyre, çmimin, rreziqet, pengesat ekonomike, juridike dhe pengesa të tjera për të hyrë ose për të dalë nga tregu, do të menaxhohen dhe përshtaten konform tendencave pozitive të AHTsë. Transaksioni i propozuar është transaksion që ka efekt në tregun gjeografik të ndërkombëtar duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, e regjistruar si degë e huaj .

Nga transaksioni nuk do të rezultojnë efekte negative për konkurrencën dhe për konsumatorët në Republikën e Kosovës, sepse me këtë blerje Grupi nuk krijon pozitë të re dominuese në territorin e Shqipërisë e rrjedhimisht as në Kosovë (me degën e saj të regjistruar si American Hospital Kosova).

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës që mund të lindin nga zbatimi i përqendrimit. Gjithashtu theksojmë se për këtë arsye dhe jo vetëm, Autoriteti bënë publikimin e Njoftimit të Përqendrimit në webfaqe, me ç'rast konfirmojmë se nuk kemi pranuar ndonjë ankesë nga palët e treta respektivisht konkurrentët potencial të mundshëm.

# BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR



- |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka marrë pjesë në seminarin në temën “Konceptet bazike dhe procedurat e ligjit të konkurrencës për zyrtarët e rinj të Autoriteteve”.</li> <li>2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka marrë ftesën zyrtare nga RCC dhe OECD-GVH, që të marrin pjesë në seminarin me temën “Hetimi dhe kontrolli i bashkimeve”.</li> <li>3.</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Me rastin e 11-të vjetorit të bashkëpunimit të FTC-së (U.S. Federal Trade Commission) dhe Autoritetit të Konkurrencës së Lituanisë, AKK ishte pjesëmarrës në këtë konferencë</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>2. AKK morri pjesë në UNCTAD me qëllim të pjesëmarrjes në sesionin e 17-të të Grupit ndërqeveritar të ekspertëve mbi ligjin dhe politikën e konkurrencës, që ka për trajtim temën: “Ofrimi i bashkëpunimit ndërqeveritar dhe shkëmbimi i praktikave në zhvillimet e fundit mbi ligjin dhe politikën e konkurrencës”.</li> </ol> |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|



- |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. AKK ishte pjesëmarrës në Punëtorin me temat: “Kartelet në epokën digjitale” dhe “Rregullimi i konkurrencës në frymën e digjitalizimit” dhe duke pasë për bazë rëndësinë e temave që do të trajtohen u vendos si në dispozitiv.</li> <li>2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka marrë pjesë në seminarin në temën “Mjetet për zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara - karteleva”.</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe ai Turk me dt. 10.04.2018 nënshkruan memorandum të mirekuptimit.</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe ai Kroat me dt.06.07.2018 nënshkruan memorandum të mirekuptimit për nxitjen dhe përf forcimin e bashkëpunimit në zbatimin e ligjit të konkurrencës të Shteteve të Palëve dhe politikën e konkurrencës në përputhje me këtë Memorandum.</li> <li>3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka marrë ftesën zyrtare nga Autoriteti Kroat i Konkurrencës - AZTN që të marrë pjesë në konferencën</li> </ol> |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|



|                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                              |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka marrë ftesën zyrtare nga OECD-ja që të marrin pjesë në takimin e lartëpërmendur në temat: “Si mundet konkurrenca të kontribuojë në vetëdijesimin e shoqërisë”, “Fuqitë investiguese në praktikë” dhe “Ligji i konkurrencës dhe Kompanitë Publike”. | ndërkombëtare në temën “Shkëmbimi i informatave mbi çmimet dhe roli profesional i asociacioneve dhe odave ekonomike” dhe përfaqësimi i Autoritetit tonë konsiderohet me rëndësi të veçantë, andaj u vendos si në dispozitiv. |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

## PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA TË PARAQITURA NË FORMË TABELARE

| AKK kundër K.S “DARDANIA-EUROSIG” Sh.a |                                                                         |                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                        |                      |
|----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Data e përfaqësimeve                   | Gjykata                                                                 | Objekti i trajtimit                                                           | Refuzohet apo Aprovohet                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Ankimimi                                                                               | Përshkrimi i seances |
| 11.01.2018<br>K.S “EUROSIG” sh.a       | Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative | AKTGJYKIM A.nr.2417/14 dt. 30.11.2017 ; Me Nr. Prot.10/18-01/H dt 11.01.2018. | I. Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimit “Eurosig” Sh.a., me seli në Prishtinë.<br>II. Anullohet vendimi I Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nr.5/10, të datës 27.12.2010 dhe paditësi lirohet nga sanksioni administrative prej 100 000 (njëqind mijë euro) I shqiptuar nga I padituri; |                                                                                        |                      |
| 23.01.2018                             | Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKK kundër K.S “Eurosig” sh.a., Vendimi nr. 5/10 dt 27.12.2010                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | ANKESË Kundër Aktgjykimit të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje |                      |

|            |                                                                                      |                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                             |  |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 29.10.2018 | Gjykata e Apelit e Kosovës<br>Prishtinë -<br>Departamenti për Çështje Administrative | AKTGJYKIM<br>A.nr.85/2018 dt.<br>10.10.2018 ; Nr.<br>Prot.376/18-01/H<br>dt 29.10.2018.                      | Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Prishtinë , ndërsa aktgjykimi I Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr 2417/2014, I datës 30.11.2017, vërtetohet | Administrative<br>Anr.2417/144 dt.<br>30.11.2017 ;Nr. Prot<br>30/18-05/D datë<br>23.01.2018                                                                                                                 |  |
| 09.11.2018 | Gjykata Supreme e Kosoves                                                            | AKK kundër K.S<br>“Eurosig” sh.a.,<br>Aktgjykimi I<br>Gjykatës së Apelit<br>A.nr.85/2018 dt.<br>10.10.2018 ; |                                                                                                                                                                                                                                            | ANKESË Kundër<br>Aktgjykimit të<br>Gjykatës Themelore<br>në Prishtinë -<br>Departamenti për<br>Çështje<br>Administrative A.A<br>nr.85/2018 dt.<br>10.10.2018 ;Me Nr.<br>Prot 376/18-01/H<br>datë 29.10.2018 |  |
| 21.01.2019 | Gjykata Supreme e Kosoves                                                            | AKTGJYKIM                                                                                                    | Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                             |  |

|  |  |                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                               |  |  |
|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
|  |  | ARJ-<br>UZVP.nr.68/2018<br>dt. 05.12.2018 ; Me<br>Nr. Prot.14/19-<br>01/H dt<br>21.01.2019. | paditurit Autoriteti<br>Kosovar I<br>Konkurrencës për<br>rishqyrtim të<br>jashtëzakonshëm të<br>vendimit gjyqësor,<br>paraqitur kundër<br>aktgjykimit të<br>Gjykatës së Apelit AA-<br>UZH nr. 85/2018 të<br>datës 10.10.2018. |  |  |
|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

| AKK kundër K.S “ CROATIA SIGURIMI” sh.a |                                                                                   |                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                            |                      |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Data e përfaqësimeve                    | Gjykata                                                                           | Objekti I trajtimit                                                                                         | Refuzohet apo Aprovohet                                                                                                                                                                                                                       | Ankimimi                                                                                                                                                                   | Përshkrimi I seancës |
| 05.02.2018                              | Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKTGJYKIM A.A.nr.501/2017 dt. 23.01.2018 ; Nr. Prot.49/18-01/H dt 05.02.2018                                | Refuzohet si e pabazuar ankesa e te paditurit Autoriteti Kosovar I Konkurrencës në Prishtinë, ndersa aktgjykimi I Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje Administrative, A.nr. 2416/2014, te dates 07.09.2017, vertetohet. |                                                                                                                                                                            |                      |
| 16.02.2018                              | Gjykata Supreme e Kosovës                                                         | AKK kundër K.S “Croatia Sigurimi” sh.a,. Aktgjykimi I Gjykatës së Apelit AA.nr.501/2017 dt. 23.01.2018 ; Nr |                                                                                                                                                                                                                                               | ANKESË Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.A nr.501/2017 dt. 23.01.2018 ;Nr. Prot 49/18-01/H datë 05.02.2018 |                      |
| 14.06.2018                              | Gjykata Supreme e Kosovës                                                         | AKTGJYKIM ARJ- UZVP.nr.37/2018 dt. 10.05.2018 ; Nr. Prot.246/18-01/H dt 14.06.2018.                         | Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditurit Autoriteti Kosovar I Konkurrencës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA-UZH nr.                                           |                                                                                                                                                                            |                      |

|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|-------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 | 501/2017 te dates<br>23.01.2018.                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
| <b>AKK kundër K.S “SIGKOS” sh.a</b> |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
| <b>Data e përfaqësimeve</b>         | <b>Gjykatat</b>                                                                   | <b>Objekti i trajtimit</b>                                                                      | <b>Refuzohet apo Aprovohet</b>                                                                                                                                                                                                           | <b>Ankimimi</b>                                                                                                                                                                                                                            | <b>Përshkrimi i seancës</b> |
| <b>01.02.2018</b>                   | Gjykata e Apelit e Kosoves në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKK kundër K.S “Sigkos” sh.a , anulim Vendimi nr. 5/9, datë 27.12.2010;                         | Refuzohet si e pabazuar ankesa e te paditurit Autoriteti Kosovar I Konkurrencës ne Prishtine, ndersa aktgjykimi I Gjykes Themelore ne Prishtine- Departamenti per Ceshtje Administrative, A.nr. 182/2011, I dates 20.07.2017, vertetohet |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
| <b>26.10.2017</b>                   | Gjykata Supreme e Kosoves                                                         | AKK kundër K.S “Sigkos” sh.a,. Aktgjykimi I Gjykes se Apelit AA.nr.394/2017 dt. 23.01.2018 ; Nr |                                                                                                                                                                                                                                          | ANKESE - kerkese per Rishqyrtim te Jashtezakonshe te Vendimit Gjyqesor .Kundër Aktgjykimit të Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.A nr.394/2017 dt. 23.01.2018 ;Nr. Prot 46/18-01/H datë 01.02.2018 | ;                           |
| <b>30.11.2017</b>                   | Gjykata Supreme e Kosoves                                                         | AKTGJYKIM ARJ- UZVP.nr.17/2018 dt. 01.03.2018 ; Nr. Prot.144/18-01/H dt 03.04.2018.             | Refuzohet si e pabazuar kerkese e paditurit Autoriteti Kosovar I Konkurrencës per rishqyrtim te jashtezakonshe te vendimit gjyqesor, paraqitur kunder aktgjykimit te Gjykes se Apelit AA- UZH nr. 394/2017 te dates 23.01.2018           |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
|                                     |                                                                                   |                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                             |
| 26.03.2018 | Gjykata Themelore në Prishtinë<br>- Departamenti për Çështje                |                                                                               |                                                                               |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|            |                    |                                                                                           |  |                                                                                                                                                                            |  |
|------------|--------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|            | Administrati<br>ve | AKK shkresë për<br>Agjencia për<br>Regjistrim Civil                                       |  |                                                                                                                                                                            |  |
| 27.03.2018 |                    | AKK shkresë për<br>Krenar Berisha<br>,Gjyqtar në<br>Gjykaten<br>Themelore në<br>Prishtinë |  |                                                                                                                                                                            |  |
| 27.03.2018 |                    | Agjencia për<br>Regjistrim Civil<br>shkresë për AKK                                       |  | Kërkesë                                                                                                                                                                    |  |
| 13.04.2018 |                    |                                                                                           |  | Parashtre<br>së për<br>shtyerje<br>të<br>shqyrtimi<br>t kryesor<br>për<br>lënden<br>K.S<br>“Kosova<br>e Re”<br>A.nr.110<br>7/17<br><br>Përgjigje<br>në<br>kërkesën<br>tuaj |  |



|                   |                                                                          |                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                       |  |
|-------------------|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|--|
|                   |                                                                          |                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                       |  |
| <b>05.04.2018</b> | Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKTGJYKIM K.S” Kosova e re sh.a kundër AKK, A.nr. 1107/17, dt. 26.03.2018; Me nr. prot. 147/18-01/H dt.05.04.2018 | Lejohet kërkesa për Rishikim e paditësit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë. Shfuqizohet Aktgjykimi A.nr.164/11 I datës 12.02.2014 I Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative Anullohet vendimi nr.05/8 I dates 27.1.2010 I Autoritetit Kosovar të Konkurrences me seli në Prishtinë dhe paditesi Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë lirohet nga sanksioni administrative prej 100 000 euro (njëqind mijë euro). |                                       |  |
| <b>18.04.2018</b> | Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për                         | ANKESË AKK kundër K.S “Kosova e Re” sh.a, Prishtinë                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | ANKESË Kundër Aktgjyqi mit të Gjykata |  |

|            |                                                                         |                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                   |  |
|------------|-------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|            | Çështje Administrative                                                  |                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            | Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Anr.1107/17 dt. 26.03.2018. Me nr prot 16/18-05/H dt. 18.04.2018 |  |
| 09.01.2019 | Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKTGJYKIM<br><br>K.S “Kosova e Re” sh.a kundër AKK; A.A.nr. 267/2018;Me nr prot 04/19-01/H dt 09.01.2019 | Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit Autoriteti Kosovar I Konkurrences në Prishtinë, ndersa aktgjykimi I Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti per Çështje Administrative, A.nr.1107/2017 I datës 26.03.2018,ver tetohet |                                                                                                                                   |  |
| 22.01.2019 | Gjykata Supreme e Koosves                                               |                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                            | ANKESË Kundër Aktgjyki mit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.A.nr.267/2018 dt.       |  |

|            |                                                                                                |                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                       |  |
|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|            |                                                                                                |                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                          | 13.12.20<br>18. Me<br>nr. prot.<br>18/19-<br>07/D<br>dt.22.01.<br>2019                                                                                                                                                |  |
| 14.02.2019 | Gjykata e<br>Apelit në<br>Prishtinë -<br>Departamen<br>ti për<br>Çështje<br>Administrati<br>ve | AKTVENDIM<br><br>K.S Kosova e Re<br>sh.a kundër AKK;<br>Ac..nr.<br>585/2017;Me nr.<br>prot 37/19-01/H<br>dt 14.02.2019 | Refuzohet si e<br>pathemelte<br>ankesa e<br>debitores, K.S<br>“ Kosova e Re<br>me seli në<br>Prishtinë,<br>ndërsa<br>aktvendimi I<br>Gjykatës<br>Themelore në<br>Prishtinë,<br>PPP.nr.279/201<br>5, I dates<br>29.11.2016,<br>vërtetohet |                                                                                                                                                                                                                       |  |
| 25.02.2019 |                                                                                                | AKK shkresë për<br>Hasan Shala.<br>Kryetar I<br>Gjykatës së<br>Apelit e<br>Kosovës,Prishtinë<br>.                      |                                                                                                                                                                                                                                          | Kërkesë<br>për<br>takim në<br>lidhje me<br>Aktvendi<br>min e<br>lëndës<br>K.S<br>“Kosova<br>e Re”<br>sh.a Ac.<br>Nr.<br>585/2017<br>të dt. 25<br>.01.2019.<br>Me.nr.pr<br>ot.<br>42/19-<br>07/D<br>dt.25.02.<br>2019. |  |

| AKK kundër “POSTA E KOSOVES” sh.a    |                                     |                                                                                                            |                            |          |                         |
|--------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|----------|-------------------------|
| Data e<br>përfaqësimeve              | Gjykata                             | Objekti i<br>trajtimit                                                                                     | Refuzohet apo<br>Aprovohet | Ankimimi | Përshkrimi i<br>seancës |
| 27.12.2016<br>Posta e<br>Kosoves sha | Gjykatës<br>Supreme në<br>Prishtine | AKTPADI për<br>Konflikt<br>Administrativ<br>ndaj VENDIMIT<br>të AKK<br>Nr.41/16 të<br>datës<br>06.12.2018. |                            |          |                         |

|                                                           |                                                                          |                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                     |                                                                                                                                 |
|-----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>28.02.2017</b><br><b>Posta e</b><br><b>Kosoves sha</b> | Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative | AKTVENDIM A.nr.2016/2016  | Refuzohet , kërkesa e paditëses - kërkuases Telekomi i Kosoves sh.a në Prishtinë , me të cilën ka kërkuar nga Gjykata , shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Prishtinë, me nr.41/16 të dt. 06.12.2016 , me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njejtit Vendim. |                                                                                                                     |                                                                                                                                 |
| <b>28.02.2017</b><br><b>Posta e</b><br><b>Kosoves sha</b> | Gjykata e Apelit në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative  | AKTVENDIM A.A nr. 38/2017 | Refuzohet ankesa e paditëses-kërkuases Posta e Kosoves Sh.a në Prishtinë. Vërtetohet Aktvendimi i Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 2016/2016 l dt. 28.12.2016                                                                                                      |                                                                                                                     |                                                                                                                                 |
| <b>05.10.2018</b><br><b>AKK</b>                           | Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative |                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>PËRGJIGJE NË</b><br><b>PADI A.nr</b><br><b>2016/2016,Nr</b><br><b>Prot 250/17-01/D</b><br><b>datë 05.01.2017</b> |                                                                                                                                 |
| <b>23.05.2018</b>                                         | Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative |                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                     | Në seancën e datës 23.05.2018, Gjykata merr këtë Aktvendim-Refuzohen propozimet të të autorizuarit të paditëses si të pabazuara |
| <b>08.06.2018</b>                                         | Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative |                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                     | Në seancën e datës 08.06.2018, Gjykata merr këtë Aktvendim-Mbi administrimin e                                                  |

|                   |                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                    | provave dhe fjala<br>perfundimtare. |
|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>08.06.2018</b> | Gjykata<br>Themelore në<br>Prishtinë -<br>Departamenti<br>për Çështje<br>Administrative                                                                                                                                  | AKTGJYKIM<br><br>Posta e<br>Kosoves sh.a<br>kundër AKK<br>A.nr.<br>2016/2016;                | Refuzohet si e pa<br>bazuar kërkesëpadia<br>e paditëses, Posta e<br>Kosoves Sh.a, me seli<br>në Prishtinë, me të<br>cilën ka kërkuar që<br>të anulohet vendimi i<br>te paditurit AKK në<br>Prishtinë, me<br>nr.41/16, i datës<br>06.12.2016, si i<br>kundërligjshëm,secila<br>palë I bartë<br>shpenzimet e vet a te<br>procedurës. |                                                                                                                                                                                                                    |                                     |
| <b>25.06.2018</b> | Gjykates së<br>Apelit në<br>Prishtinë -<br>Departamenti<br>për Çështje<br>Administrative                                                                                                                                 | Posta e<br>Kosovës sh.a,<br>kundër AKK për<br>anulim Vendimi<br>nr.41/16, dt.<br>06.12.2016. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | ANKESE Kundër<br>Aktgjykimit të<br>Gjykates<br>Themelore në<br>Prishtinë -<br>Departamenti<br>për Çështje<br>Administrative<br>A.A.nr.2016/2016<br>dt. 08.06.2018.<br>Me nr prot<br>287/18-01/H, dt.<br>01.08.2018 |                                     |
| <b>06.03.2019</b> | Posta e<br>Kosovës sh.a,<br>kundër AKK<br>për anulim<br>Vendimi<br>nr.41/16, dt.<br>06.12.2016.<br>Është<br>protokoluar<br>në Gjykatën e<br>Apelit me<br>A.A. nr.<br>446/18 dhe<br>gjendet në<br>procedurë<br>shqyrtimi. |                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                    |                                     |

## SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vazhdon të jetë i ballafaquar me sfida si të aspektit teknik, organizativ e funksional, siç janë:

1. Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës është ndryshuar me plotësim ndryshimin nr. 04/L-226 ndërsa sfida në vete mbetet që ky Ligj të harmonizohet me Direktivat e BE-së,
2. Statuti i Autoritetit duhet të harmonizohet me Ligjin në fuqi,
3. Trajnimi i gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë dhe adekuate të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të së drejtës europiane në këtë fushë, me synim arsyetimin e vendimeve të tyre, bazuar në një vlerësim real të konkurrencës, si një e mirë publike.
4. Avokimi me bizneset e mëdha, të mesme dhe të vogla.
5. Avokim me mediat të cilat janë një faktor shumë i rëndësishëm.
6. Ngritjen e kapaciteteve (trajnimi) të stafit në përgjithësi.
7. Monitorimi dhe fillimi i procedurave për shkelësit e Konkurrencës (*sipas detyrës zyrtare*) ex officio.
8. Sfide e Autoritetit mbetet kontrollat e paparalajmeruar ndaj ndermarrjeve dhe konfiskimi i fakteve.
9. Sfide e Autoritetit gjithashtu mbetet promovimi i programit të lehtësirave nga ndermarrjet.
10. Sfide tjetër e AKK-se mbetet vendosja e gjobave ndaj shkelësve të konkurrencës në mënyrë meritore.
11. Sfide tjetër e autoritetit është përdorimi i rethanave lehtësuese dhe renduese bazuar në Ligj.
12. Bashkëpunimi i ngushtë me projektet e ofruara Autoritetit të Konkurrencës, në avansimin, ngritjen e kapaciteteve, marrjen e përvojave të BE-së dhe bashkëpunimet me Autoritetet e konkurrencës si motra dhe ato me gjere.
13. Viti 2018 karakterizohet me Bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare mirpo ende nuk është në nivelin e duhur mbetet sfida që të vazhdohet edhe për vitet në vijim, përmes takimeve dhe Memorandumeve të Bashkëpunimit.
14. Bashkëpunimi ndërkombëtar vlerësohet i rëndësishëm, veçanërisht në drejtim të rritjes së ekspertizës, të azhurnimit me tendencat e momentit dhe të rritjes së reputacionit të Autoritetit.
15. Dinamika e zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend, së bashku me objektivat mëdha që ka vendi në raport me të ardhmen e tij evropiane, krijojnë në vazhdimësi

një ambient të përgjithshëm sfidues për të gjithë aktorët e rëndësishëm institucionale në fushën e vendimmarrjes dhe rregullimit të konkurrencës në përgjithësi.

16. Misioni i Autoritetit është si garantues i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, do të mbetet prioriteti madhor i punës sonë në vitin 2019. Autoriteti do të mbetet një avokat i përkushtuar i konkurrencës së lirë dhe interesave të konsumatorit duke besuar se vetëm në këtë mënyrë do të përmbushë synimin final për më shumë zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.

### **Rekomandimet e Autoritetit për vitin 2019**

Në përputhje me objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara për vitin 2018 dhe në përputhje me dispozitat e pikës së dhjetë të parë të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe të pikës së parë të paragrafit të dytë të nenit 12 të Statutit, Autoriteti rekomandon si prioritet të politikës së konkurrencës për vitin 2018, këto aktivitete:

1. Përgatitja e një Strategjie të punës për periudhën 2019 - 2021.
2. Edhe perkunder qe AKK ka plotesuar shume akte nenligjore qe kane qene ne mungese kemi nevoj qe te plotesojme Autoitetin edhe me akte te tjera nenligjore,
3. Krijimi i një baze të të dhënave, përmes të cilës do të bëjmë grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.
4. Rritja e stafit,
5. Përgatitja e disa pamfletëve bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përmes të cilave duhet kushtuar një rëndësi të madhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për përfitimet që vijnë nga konkurrenca apo rritjen e kulturës së konkurrencës.
6. Bashkëpunimi me rregullatorët tjerë të tregut, përmes të cilëve synojmë të bëjmë transparencën e veprimtarisë së punës së AKK-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare, duke rritur vazhdimisht bashkëpunimin me entet e ndryshme publike, veprimtaria e të cilëve mund të ketë ndikim në konkurrencë.
7. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve që iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, duke dhënë rast pas rasti rekomandimet përkatëse.
8. Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimeve të inspektorëve, me qëllim rritjen e ekspertizës jo vetëm për hetimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg.
9. Fokusi i veprimtarisë së Autoritetit ka qenë jo vetëm monitorimi, analizimi, dhe evidentimi i situatave të paqarta dhe të dyshimta por edhe propozimi i masave dhe rekomandimeve konkrete për kapërcimin e tyre. Moto jonë institucionale përgjatë gjithë vitit të kaluar ishte se nxitja dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë mbi gjithçka i shërben interesave të konsumatorit të thjeshtë dhe prosperitetit ekonomik dhe social

**Parimet udhëheqëse mbi bazën e të cilave zbatohet ligji, politikat konkurruese dhe veprimtaria e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës janë:**

1. Parimi i Publicitetit dhe Transparencës si një nga parimet baze,
2. Përgjegjshmëria
3. Barazia.

4. Efienca dhe Efektiviteti
5. Zbatimi i parimeve të konkurrencës në mënyrë që nuk lejon diskriminim të ndërmarrjeve ekonomike në rrethana të njëjta.
6. Gjithëpërfshirja nënkupton një zbatim të gjerë të parimeve rregullatore dhe të konkurrencës në veprimtari ekonomike, ku hyjnë: veprimtaritë e biznesit privat dhe atij publik, njohjen e përmasave të konkurrencës në politikat e zhvillimit dhe reformat që ndikojnë në funksionimin eficient të tregjeve, mbrojtjen e procesit të konkurrencës dhe krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi për konkurrence të lirë eficiente dhe efektive.
7. Rishikimi i ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, rishikimi i bazës nënligjore dhe i strukturës organizative të institucionit vlerësohen prioritare për vitin 2019. Përshtatja e tyre me sfidat e kohës dhe përputhshmëria me frymën e BE do të jenë drejtimet ku do të ndalemi më konkretisht.  
Në emër të Autoritetit të Konkurrencës dëshiroj të garantoj Kuvendin e Kosoves se veprimtaria e tij do të jetë në frymën e ligjit në rezonancë të plotë me objektivat kombëtare për zhvillimin ekonomik financiar të qëndrueshëm të vendit dhe përafrimin e pandërprerë me Bashkimin Europian.

## Prioriteti i parë

Autoriteti do ta forcojë aftësinë e tij për zbulimin e praktikave të kufizimit të konkurrencës dhe atë sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) si një mjet thelbësor për hetimin dhe sanksionimin e veprimeve të paligjshme, me qëllim të zhbindjes (zmbrajjes) së sjelljeve ilegale dhe në këtë mënyrë të ndikojë në rritjen e stimujve të konkurrencës për kompanitë që të garojnë në mes vërti me anë të meritës.

- a. Në veçanti, lidhur me prokurimin publik, Autoriteti do të vazhdojë të punoj për analizimin e informacionit për procedurat e prokurimit publik në sektorët e shpenzimeve të rëndësishme publike kombëtare, me qëllim të identifikimit të gjurmëve të marrëveshjeve të fshehta.
- b. Në mënyrë që të rritë veprimtarinë hetimore në vitin 2018, do të bashkëpunojë me parashtruesit e ankesave, si një nga burimet kryesore të informacionit për zbulimin e praktikave kufizuese. Për këtë qëllim, do të zhvillohet zbatimi i ankesave të reja në portalet elektronike, si dhe do të instalohet një linjë e dedikuar telefonike. Këto instrumente pretendojnë për ta lehtësuar paraqitjen e ankesave për Autoritetin nga qytetarët dhe kompanitë të cilët janë viktima potenciale të sjelljes anti konkurruese, ose të cilët janë në dijeni të praktikave të paligjshme. Këto instrumente do të sjellin efikasitet më të madh operacional për zhvillimin e shpejt dhe në mënyrë efektive të hetimeve.
- c. Gjatë vitit 2018, Autoriteti në vazhdimësi do t'i përmirësojë procedurat e saj të brendshme në mënyrë që ta zvogëlojë kohën për hetimin e kufizimeve të konkurrencës dhe për të rritur sigurinë juridike për kompanitë.
- d. Në vitin vijues 2018, për luftimin e praktikave të cilat e kufizojnë konkurrencën do të përdoren mjetet hetimore efikase dhe të kombinuara. Gjatë këtij viti Autoriteti do të përdorë mjetet më të përshtatshme për nxjerrjen e dëshmive, duke e bërë konsolidimin e procedurave për kryerjen e hetimeve, veçanërisht në ambientet digjitale, si dhe për trajtimin e provave të mbledhura. Ai do të ketë përfitime edhe nga mos respektimi i skadencave të afateve ligjore për ushtrimin e ankesave lidhur me Aktgjykimet e nxjerra jo përfundimtare.



## Prioriteti i dytë

Luftimi karteleve në ekonominë e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2018, lufta kundër karteleve do të jetë njëri prej prioriteteve të Autoritetit, sepse ato i sjellin dëm ekonomisë kombëtare dhe konsumatorëve, qofshin ata si ndërmjetësues ose si akterë të fundit.

Koordinimi në mes të kompanive konkurruese, duke i fiksuar çmimet, mandej duke e bërë ndarjen e tregjeve gjeografike ose të konsumatorëve, apo duke e bërë kufizimin e prodhimit në atë mënyrë e cila mundëson rritjen e çmimeve, është shkelje më e rëndë e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Autoriteti do ta bëjë promovimin e luftës kundër karteleve, pavarësisht nga lloji ose forma konkrete e Marrëveshjes së tregut relevant (përkatës), apo të madhësisë së kompanive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë prokurimit publik, por edhe marrëveshjeve të cilat ndikojnë te konsumatorët e fundit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

Në këtë kontekst, Autoriteti do ta vendosë në prioritetet e aktivitetit të saj edhe promovimin e programit të lehtësimit të ndëshkimeve, i cili siguron imunitet ose ulje të gjobave për kompanitë apo për administratorët, nëse ata e pranojnë pjesëmarrjen e tyre në një kartel dhe nëse bashkëpunojnë me hetuesit e Autoritetit. Rritja e ndërgjegjësimit për programin e lehtësimeve do t'i përfshijë edhe palët e angazhuara të interesit, duke përfshirë komunitetet ligjore dhe të biznesit në Republikën e Kosovës.

Programi i lehtësimit (*zbutjes*) do të përforcohet edhe më tej me miratimin e vendimeve sanksionuese. Këto vendime do të jetë ligjërish dhe ekonomikisht të shëndosha dhe do të parashikojnë sanksione të duhura për objektivat e parandalimeve të veçanta dhe të përgjithshme.

Pas deklarimeve të dhëna në vitin 2016 për t'i luftuar manipulimet e ofertave në prokurimin publik, Autoriteti do të bashkëpunoj ngushtë me organet vendimmarrëse dhe organet tjera përgjegjëse në prokurimin publik. Ky bashkëpunim ka për synim shkëmbimin e praktikave më të mira të cilat e lehtësojnë jo vetëm parandalimin, por edhe zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në procedurat e prokurimit publik.

## Prioriteti i tretë

Praktikat tjera të cilat e kufizojnë konkurrencën në ekonomi.

Përveç luftës kundër karteleve, prioritetet e Autoritetit gjithashtu përfshijnë edhe hetimin dhe sanksionimin e kufizimeve vertikale të konkurrencës, të tilla si ruajtja e çmimeve të rishitjes ose mbrojtja absolute territoriale e distributorëve, si dhe abuzimi me pozitën dominuese.

## Marrja e vendimeve me transparencë

Përdorimi i sanksioneve për shkeljet e ligjit të konkurrencës duhet të bazohet në rolin e tyre për parandalimin e veçantë dhe të përgjithshëm, të të penguarit e shfaqjeve dhe sjelljeve të paligjshme.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për ndëshkim në përputhje të plotë me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, Autoriteti do t'i zbatoj sanksionet në përputhje me udhëzimin e publikuar për aplikimin e gjobave.

Në vitin 2018, Autoriteti do të vazhdojë t'i promovojë procedurat e zgjidhjeve dhe të angazhimeve, në të cilat kërkohen, instrumentet me përfitime në aspektin e arritjeve të efikasitetit të procedurave.

Në veprimtarinë e tij, Autoriteti do t'i kushtojë vëmendje të afërt të drejtave të mbrojtjes dhe procesit të rregullt.

## Kontrolli më efikas i bashkimit (*përqendrimit*)

Në kontrollin e bashkimit (*përqendrimit*), Autoriteti do t'i përcaktoj si prioritete shpejtësinë dhe efikasitetin e veprimeve të tij dhe atë si në bashkimet komplekse ashtu edhe në ato jokomplekse. Autoriteti do të synojë reduktimin e barrës burokratike të palëve në procedurat e kontrollit të bashkimit.

Në vitin 2018, Autoriteti do ta zvogëlojë kohëzgjatjen mesatare të procedurave të bashkimit, rreth 5% deri në 10%.

Autoriteti gjithashtu do të përforcojë zbulimin e bashkimeve (*përqëndrimeve*) të cilat, pavarësisht nga përmbushja e kriterëve të njoftimit, nuk janë paraqitur tek Autoriteti.

Qëllimi i Autoritetit është ruajtja dhe zhvillimi i interesit të konsumatorëve të ndërmjetëm dhe të atyre të fundit, në konkurrencën efektive në treg, siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## RAPORTI FINANCIAR

Raportimi financiar është sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme dhe përmbushë të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe nga Ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116, nr.04/L-194, nr.05/L-007 dhe nr.05/L-063.

Të dhënat janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur. Zhvillimet buxhetore të AKK-së në vitin 2018, ishin si në vijim:

Buxheti i ndarë ishte 267,074.39€ dhe ishin të dedikura: 202,537.38€ për paga dhe mëditje, 59,861.00€ për mallra dhe shërbime dhe 4,676.01€ për shpenzime komunale. Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planit të rrjedhës së parasë, të përgatitur nga Zyrtari kryesor financiar - ZKF në bashkëpunim me Menaxhmentin e AKK-së.

Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar sipas kategorive:

| Nr. | Kategoria           | Buxheti i lejuar   | Buxheti i shpenzuar | Përqindja e shpenzuar |
|-----|---------------------|--------------------|---------------------|-----------------------|
| 1.  | Paga dhe mëditje    | 202,537.38€        | 202,537.38€         | 100.00 %              |
| 2.  | Mallra dhe Shërbime | 59,861.00€         | 57,763.12€          | 96.50 %               |
| 3.  | Shpenzime Komunale  | 4,676.01€          | 1,108.59€           | 23.71 %               |
|     | <b>TOTALI</b>       | <b>267,074.39€</b> | <b>261,409.09€</b>  | <b>97.88%</b>         |

Periudha e raportimit është nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018

## RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-IT

### RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZKA-së

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA, në bazë të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2017.

Në vijim po japim të gjeturat, rekomandimet, veprimet e menaxhmentit, datat e planifikuara të përfundimit të veprimit të menaxhmentit dhe personin përgjegjës.

## SHTOJCAT

### ORGANOGRAMI I AKK-së

